RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “”Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9374, datë 21.04.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit...
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Transpozim i BE-së
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	*Rregullore e Këshillit (BE) 2015/1589 (BE) e 13 korrikut 2015 “Mbi përcaktimin e rregullave të hollësishme për zbatimin e Nenit 108 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (kodifikim)*
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2025-2027 VKM nr. 621, datë 10.10.2024 “Për miratimin e dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027” në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	07/05/2026 - 06/07/2026
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	01/05/2026
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po **10/11/2026**
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2026 – MEI - 14
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Eralda Shtylla

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)

Problemi kryesor lidhet me nevojën për forcimin e pavarësisë institucionale dhe operacionale të funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore, i cili aktualisht ushtrohet nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore si organ vendimarrës me kryetar ministrin përgjegjës për ekonominë dhe anëtarë përfaqësues të ministrive të linjës si edhe sekretariatin e ndihmës shtetërore si strukturë tekniko-administrative brenda strukturës përgjegjëse për ekonominë, duke krijuar kufizime për një ndarje të qartë ndërmjet autoritetit kontrollues dhe institucioneve publike që veprojnë si dhënëse të ndihmës shtetërore. Gjithashtu, kuadri aktual ligjor parashikon nevojën për forcimin e kapaciteteve administrative, teknike, hetimore dhe monitoruese, si dhe të instrumenteve për zbatimin efektiv të rregullave të ndihmës shtetërore. Këto nevoja janë evidentuar edhe në Raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe reflektohen në angazhimet e Agjendës Kombëtare të Reformave 2024-2027. Gjatë procesit të hartimit të reformës u shqyrtuan alternativa të ndryshme institucionale për garantimin e një funksioni më të pavarur dhe efektiv të kontrollit të ndihmës shtetërore, përfshirë edhe mundësinë e krijimit të një strukture të veçantë të pavarur. Megjithatë, pas vlerësimit të alternativave dhe ndikimeve përkatëse, u analizua se transferimi i funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore tek Autoriteti i Konkurrencës, me Komisionin e Konkurrencës si organ vendimmarrës, përbën zgjidhjen më eficiente dhe proporcionale për garantimin e pavarësisë funksionale, shfrytëzimin më të mirë të kapaciteteve ekzistuese institucionale dhe përmbushjen e kërkesave të *acquis* të Bashkimit Evropian.

Aktualisht, Shqipëria ndodhet në një fazë kritike të negocimit të Kapitullit 8 "Konkurrenca". Megjithëse hapat e ndërmarrë që nga viti 2005 kanë qenë thelbësore, kuadri aktual paraqet hendeqe në raport me Direktivën (BE) 2019/1 (Direktiva ECN+) dhe Rregulloren (BE) 2015/1589.

Këto mangësi lidhen kryesisht me:

1. **Pavarësinë e Autoritetit:** Nevoja për të shndërruar KNSH-në në një organ plotësisht të pavarur, me buxhet dhe burime njerëzore të dedikuara, jashtë varësisë direkte të ministrisë.
2. **Kompetencat Hetimore dhe Sanksionuese:** Nevoja për t'i dhënë Autoritetit fuqi për të kryer hetime sektoriale dhe për të vendosur gjoba administrative në rast të mosbashkëpunimit apo dhënies së informacionit të rremë.
3. **Transparencën dhe Monitorimin:** Nevoja për një sistem raportimi dhe publikimi të automatizuar që të garantojë se asnjë skemë ndihme nuk mbetet e paautorizuar.

Kjo reformë e re ligjore vjen si një domosdoshmëri për të përmbushur detyrimet e MSA-së dhe për të garantuar një mjedis konkurrues të barabartë, duke mbyllur ciklin e reformave të nisura në vitin 2005 dhe duke e përafruar Shqipërinë me standardet më të larta të kontrollit ekonomik në Bashkimin Evropian.

Shkaqet kryesore të problemit:

- Nevoja për forcimin e pavarësisë operacionale dhe paanshmërisë së funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore.
- Nevoja për një ndarje më të qartë institucionale ndërmjet funksionit të kontrollit dhe institucioneve publike që japin ndihmë shtetërore.

- Nevoja për përafrim të mëtejshëm me acquis të Bashkimit Evropian, veçanërisht me Rregulloren (BE) 2015/1589 dhe parimet e pavarësisë institucionale të reflektuara në Direktivën (BE) 2019/1.
- Nevoja për forcimin e kapaciteteve administrative, profesionale, teknike dhe hetimore për ushtrimin efektiv të funksioneve të shqyrtimit, monitorimit dhe kontrollit.
- Nevoja për përmirësimin e mekanizmave të monitorimit dhe transparencës përmes administrimit të të dhënave dhe regjistrit të ndihmës shtetërore.
- Nevoja për forcimin e instrumenteve të zbatimit, përfshirë sanksionet procedurale në rast mosdhënieje ose dhënieje të informacionit të pasaktë.
- Nevoja për zgjerimin dhe zbatimin më efektiv të kontrollit të ndihmës shtetërore edhe në sektorët e bujqësisë dhe peshkimit, në përputhje me acquis të BE-së.
- Nevoja për sigurimin e burimeve njerëzore, financiare dhe teknike të nevojshme për ushtrimin e pavarur dhe efektiv të funksionit të kontrollit.
-

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)

Objektivat e harmonizimit të legjislacionit për ndihmën shtetërore me *acquis* të BE-së dhe forcimit të pavarësisë institucionale janë si vijon:

- Sigurimi i përputhshmërisë së plotë me Rregulloren (BE) 2015/1589 dhe Direktivën ECN+,
- Forcimi i mekanizmave të monitorimit dhe kontrollit të ndihmës shtetërore deri në vitin 2028, duke siguruar verifikimin periodik të zbatimit të skemave dhe raportimin vjetor të tyre.
- Ulja e rasteve të ndihmës shtetërore të paautorizuar deri në fund të vitit 2028, përmes forcimit të procedurave të njoftimit paraprak dhe monitorimit institucional.

Ky objektiv synon të lehtësojë mbylljen e negociatave teknike për Kapitullin 8 deri në vitin 2027 dhe të përmbushë kriteret e anëtarësimit deri në vitin 2030.

- Transferimi i funksionit të ndihmës shtetërore pranë Autoritetit të Konkurrencës brenda vitit 2026, duke siguruar autonomi financiare dhe administrative nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, me një strukturë të dedikuar që garanton paanësinë në vendimmarrje.
- Funksionalizimi i Regjistrit Digjital të Ndihmës Shtetërore deri në dhjetor 2027. Sistemi do të mundësojë shkëmbimin e automatizuar të të dhënave me institucionet dhënëse (ministritë/bashkitë) dhe publikimin e çdo skeme ndihme brenda 10 ditëve nga aprovimi, duke rritur transparencën me 100%.
- Rritja e efikasitetit të rikuperimit të ndihmës së paligjshme, duke synuar që brenda vitit 2027, të paktën 90% e vendimeve për rikuperim të ekzekutohen brenda afateve ligjore, duke reduktuar kështu deformimet e konkurrencës në treg.
- Digjitalizimi i procesit të njoftimit dhe monitorimit të ndihmës shtetërore deri në fund të vitit 2027, duke mundësuar që 100% e aplikimeve për autorizim të kryhen online dhe duke ulur kohën e shqyrtimit administrativ me 40%.

-

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikës për forcimin e pavarësisë, efektivitetit dhe përafrimit të sistemit të kontrollit të ndihmës shtetërore me acquis të Bashkimit Evropian:

Opsioni 0 : Ky opsion lidhet me vijimin e kuadrit aktual ligjor dhe institucional. Ky opsion shmang kostot e riorganizimit institucional, por nuk adreson nevojën e evidentuar për forcimin e pavarësisë operacionale të funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore, kapaciteteve administrative dhe instrumenteve efektive të monitorimit dhe zbatimit. Për pasojë, mbeten të pranishme mangësitë e identifikuara në raportet e Komisionit Evropian.

Opsioni 1 (Krijimi i një autoriteti të ri të pavarur të kontrollit të ndihmës shtetërore): Ky opsion u konsiderua si një alternativë që do të garantonte nivelin më të lartë të pavarësisë institucionale, përmes krijimit të një organi të posaçëm me kompetenca të plota vendimmarrëse, monitoruese dhe sanksionuese. Megjithatë, ai do të kërkonte krijimin e një institucioni të ri publik, ngritjen e strukturave të reja administrative, sigurimin e burimeve shtesë njerëzore, financiare dhe teknike, si dhe një periudhë më të gjatë tranzicioni për operacionalizimin e plotë të tij.

Opsioni 2 (Ndryshimi i ligjit ekzistues dhe transferimi i funksionit te Autoriteti i Konkurrencës) – Opsioni i preferuar: Ky opsion parashikon transferimin e funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe përcaktimin e Komisionit të Konkurrencës si organ vendimmarrës, duke garantuar forcimin e pavarësisë funksionale, kapaciteteve administrative dhe instrumenteve të zbatimit. Avantazhi kryesor qëndron në faktin se objektivat e reformës realizohen përmes përdorimit të një institucioni ekzistues të pavarur, me përvojë në fushën e konkurrencës dhe me kosto më të ulëta krahasuar me krijimin e një autoriteti të ri. Për këtë arsye, pas vlerësimit të alternativave, ky opsion u konsiderua zgjidhja më efektive dhe proporcionale.

Opsioni 3 – Përmirësimi i mekanizmave të zbatimit dhe forcimi i kapaciteteve të strukturës ekzistuese të kontrollit të ndihmës shtetërore (Opsion jorregullator).

Ky opsion parashikon forcimin e kapaciteteve administrative dhe profesionale të strukturës ekzistuese të kontrollit të ndihmës shtetërore, pa ndryshuar kuadrin ligjor dhe strukturën institucionale aktuale. Ndërhyrja do të realizohej nëpërmjet trajnimeve të specializuara për stafin, përmirësimit të koordinimit ndërinstitucional me institucionet dhënëse të ndihmës shtetërore, hartimit të udhëzuesve metodologjikë, përmirësimit të mekanizmave të monitorimit dhe zhvillimit të mjeteve digjitale për mbledhjen, administrimin dhe publikimin e informacionit mbi ndihmën shtetërore. Ky opsion synon rritjen e efektivitetit, transparencës dhe kapaciteteve të sistemit ekzistues, duke shfrytëzuar burimet dhe strukturat aktuale, por nuk adreson problematikën e mungesës së pavarësisë operacionale të Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

Opsioni i preferuar: Opsioni 2, pasi arrin të adresojë problemet e identifikuara lidhur me pavarësinë, efektivitetin dhe përafrimin me acquis të BE-së, duke shmangur njëkohësisht kostot dhe ngarkesat administrative që do të sillte krijimi i një institucioni të ri të dedikuar.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 10 rreshta)

Opsioni i preferuar, që konsiston në ndryshimin e kuadrit ligjor ekzistues dhe transferimin e funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore pranë Autoritetit të Konkurrencës, sjell kryesisht ndikime institucionale, administrative dhe rregullatore, pa krijuar një institucion të ri publik. Për buxhetin e shtetit, ndikimi lidhet me nevojën për sigurimin e burimeve njerëzore, financiare dhe teknike, si dhe me përshtatjen e strukturës organizative dhe funksionale të Autoritetit të Konkurrencës; në këtë fazë kostot nuk janë kuantifikuar dhe do të përcaktohen gjatë zbatimit të reformës. Për administratën publike, ndikimi lidhet me transferimin e kompetencave, dosjeve, arkivit, bazave të të dhënave dhe procedurave në vijim nga ministria përgjegjëse te Autoriteti i Konkurrencës. Për institucionet publike dhënëse të ndihmës shtetërore, pritet forcim i mekanizmave të monitorimit, raportimit dhe zbatimit të vendimeve. Për ndërmarrjet dhe përfituesit e ndihmës shtetërore, reforma pritet të rrisë transparencën, parashikueshmërinë dhe sigurinë juridike, ndërkohë që forcon zbatimin e rregullave të ndihmës shtetërore dhe parashikon masa administrative në rast të mosrespektimit të detyrimeve ligjore. Zgjerimi i fushës së zbatimit të ligjit në sektorët e bujqësisë dhe peshkimit kërkon gjithashtu përshtatjen e praktikave administrative dhe bashkëpunim më të ngushtë me autoritetet përgjegjëse në këta sektorë.

Opsioni i preferuar

Pas vlerësimit të alternativave, **Opsioni 2 (ndryshimi i ligjit ekzistues dhe transferimi i funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore te Autoriteti i Konkurrencës)** konsiderohet zgjidhja më efektive dhe proporcionale, pasi adreson nevojën për forcimin e pavarësisë, efektivitetit dhe përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian, duke shfrytëzuar strukturat ekzistuese institucionale dhe duke minimizuar kostot administrative që do të sillte krijimi i një autoriteti të ri të dedikuar.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta).

Opsioni i preferuar është **Opsioni 2 – Ndryshimi i ligjit ekzistues dhe transferimi i funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore tek Autoriteti i Konkurrencës**.

Ky opsion u përzgjodh pas vlerësimit të alternativave për forcimin e pavarësisë institucionale dhe efektivitetit të kontrollit të ndihmës shtetërore. Fillimisht u konsiderua edhe mundësia e krijimit të një autoriteti të ri të dhe të pavarur, si zgjidhje që do të siguronte një ndarje të plotë institucionale nga ekzekutivi. Megjithatë, analiza tregoi se objektivat e reformës mund të arrihen në mënyrë më efektive përmes transferimit të funksionit tek Autoriteti i Konkurrencës, duke shfrytëzuar kapacitetet institucionale ekzistuese dhe duke shmangur kostot që do të lidhen me krijimin e një institucioni të ri publik.

Opsioni 0 (Status quo) nuk u konsiderua i përshtatshëm, pasi nuk adreson nevojën e evidentuar për forcimin e pavarësisë operacionale, kapaciteteve administrative dhe instrumenteve të monitorimit dhe zbatimit të rregullave të ndihmës shtetërore, të evidentuara edhe në raportet e Komisionit Evropian.

Opsioni 1 (Krijimi i një autoriteti të ri të posaçëm) do të siguronte një strukturë të dedikuar dhe nivel të lartë autonomie institucionale, por do të kërkonte ngritjen e një institucioni të ri, krijimin e strukturave të reja administrative, si dhe burime shtesë njerëzore, financiare dhe teknike.

Opsioni 2 (Opsioni i preferuar) mundëson transferimin e funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore tek Autoriteti i Konkurrencës dhe ushtrimin e kompetencave vendimmarrëse nga Komisioni i Konkurrencës, duke garantuar forcimin e pavarësisë funksionale, kapaciteteve administrative, instrumenteve të monitorimit dhe hetimit, si dhe vazhdimësinë e funksioneve ekzistuese gjatë periudhës kalimtare.

Nga analiza e alternativave rezultoi se ky opsion adreson realizimin e objektivit të reformës nëpërmjet një institucioni ekzistues të pavarur, shmang kostot institucionale të krijimit të një autoriteti të ri dhe siguron përafrim më efektiv me acquis të Bashkimit Evropian.

Projektligji nuk parashikon krijimin e një institucioni të ri publik, por transferimin e funksioneve të kontrollit të ndihmës shtetërore pranë Autoritetit të Konkurrencës. Për këtë arsye, efektet financiare lidhen kryesisht me përshtatjen organizative, forcimin e kapaciteteve administrative dhe teknike, si dhe sigurimin e burimeve të nevojshme njerëzore, financiare dhe teknologjike për ushtrimin efektiv të funksioneve të transferuara. Nevojat konkrete buxhetore do të përcaktohen në kuadër të riorganizimit të Autoritetit të Konkurrencës dhe procesit normal të planifikimit buxhetor, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor.

Viti 1	Viti 2	Viti 3	

KONSULTIMI

Projektligji është përgatitur nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit në kuadër të përafrimit të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e ndihmës shtetërore dhe të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Kapitulli 8 “Politika e Konkurrencës”. Projektligji është publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike më datë 06.10.2026, me afat konsultimi deri më 03.11.2026. Gjatë periudhës së konsultimit janë regjistruar 363 shikime/vlerësime të projektaktit, ndërsa nuk janë paraqitur komente ose sugjerime nga publiku.

Konsultimi institucional

Më datë 07.05.2026, projektligji është dërguar për mendim dhe konsultim pranë institucioneve kryesore të përfshira në procesin e hartimit dhe zbatimit të politikave të konkurrencës dhe ndihmës shtetërore, përfshirë Ministrinë e Drejtësisë, Ministrin e Shtetit dhe Kryenegociatorin, Autoritetin e Konkurrencës dhe Ministrinë e Financave. Projekligji wshtw shoqwruar me relacionin, Tabelën e Përputhshmërisë (Table of Concordance) dhe Analizën e Ndikimit Rregullator (RIA).

Komentet e institucioneve janë shqyrtuar dhe reflektuar sipas rastit, veçanërisht në lidhje me modelin institucional të kontrollit të ndihmës shtetërore, dispozitat tranzitore për transferimin e funksioneve dhe garantimin e ushtrimit efektiv të kompetencave të Autoritetit të Konkurrencës në këtë fushë.

Procesi i konsultimit institucional dhe publik ka kontribuar në përmirësimin e projektligjit dhe në qartësimin e mekanizmave të transferimit të funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore pranë Autoritetit të Konkurrencës. Konsultimet kanë ndihmuar në harmonizimin e dispozitave me acquis të Bashkimit Evropian, forcimin e pavarësisë operacionale të funksionit të kontrollit dhe krijimin e një kuadri më efektiv për monitorimin dhe zbatimin e rregullave të ndihmës shtetërore.
Nuk janë përdorur forma të tjera konsultimi.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)

Zbatimi i nismës do të realizohet nga Autoriteti i Konkurrencës dhe Komisioni i Konkurrencës, sipas kompetencave të përcaktuara në ligj, pas përfundimit të periudhës kalimtare gjashtëmujore për transferimin e funksioneve. Gjatë kësaj periudhe, Autoriteti i Konkurrencës dhe ministria përgjegjëse për ekonominë do të marrin masat organizative, administrative, financiare dhe teknike të nevojshme për realizimin e transferimit të funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore.

Monitorimi do të kryhet nga struktura përgjegjëse për ndihmën shtetërore pranë Autoritetit të Konkurrencës, përmes mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave, monitorimit të zbatimit të vendimeve dhe administrimit të regjistrit të ndihmës shtetërore. Rezultatet e zbatimit do të pasqyrohen në raportin vjetor për zbatimin e rregullave të ndihmës shtetërore, të cilin Autoriteti i Konkurrencës e paraqet në Kuvend brenda datës 30 qershor të çdo viti për vitin pararendës.

Monitorimi i reformës do të bazohet në tregues si numri i masave të ndihmës së njoftuara dhe shqyrtuara, shkalla e raportimit nga institucionet dhënëse, zbatimi i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, funksionimi i regjistrit të ndihmës shtetërore dhe progresi i përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e ndihmës shtetërore. Këta tregues do të pasqyrohen në raportimet periodike dhe në raportin vjetor të Autoritetit të Konkurrencës.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës.

Sistemi i kontrollit të ndihmës shtetërore në Shqipëri ka nisur të strukturohet si një instrument i rëndësishëm i politikave ekonomike dhe konkurrencës me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) në vitin 2006.

Kuadri i parë ligjor që rregulloi këtë fushë ishte Ligji nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i cili hodhi bazat për monitorimin e fondeve publike që u akordohen ndërmarrjeve të caktuara, me qëllim shmangien e deformimeve të konkurrencës në treg.

Procesi i ndërtimit të kësaj strukture ka evoluar përmes disa fazave kyçe:

- **Ligji nr. 9374/2005 "Për ndihmën shtetërore":** Ky ligj krijoi Komisionin e Ndihmës Shtetërore (KNSH) si organin vendimmarrës dhe Sekretariatin e Ndihmës Shtetërore (brenda Ministrisë përgjegjëse për Ekonominë) si organin teknik dhe ekzekutiv. Ai parashikoi format kryesore të ndihmës (subvencione, lehtësi fiskale, garanci) dhe detyrimin për njoftimin e tyre përpara dhënies.
- **Legjislacioni i posaçëm dhe sektorial:** Përveç ligjit bazë, ndihma shtetërore afekton edhe legjislacione të tjera që rregullojnë sektorë specifikë, si ligji për energjinë, transportin, dhe zonat e zhvillimit ekonomik, ku shpesh aplikohen skema mbështetëse që kërkojnë përputhshmëri me rregullat e konkurrencës.
- **Ndryshimet e vitit 2018:** Me qëllim përafrimin e mëtejshëm me acquis të BE-së, Kuvendi miratoi Ligjin nr. 20/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005". Këto ndryshime synuan forcimin e procedurave të kthimit të ndihmës së paligjshme dhe rritjen e transparencës, duke i përafruar përkufizimet me ato të neneve 107 dhe 108 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE).

Lidhur me organizimin institucional dhe procedurat e kontrollit, janë miratuar aktet në vijim:

- **Krijimi i strukturave operacionale:** Ndryshe nga regjistrimi i biznesit, kontrolli i ndihmës shtetërore ka mbetur një funksion administrativ i lidhur ngushtë me ekzekutivin. Sekretariati i Ndihmës Shtetërore funksionon si drejtori brenda ministrisë, gjë që në raportet e progresit të BE-së është identifikuar si një pikë që kërkon reformim drejt një pavarësie më të madhe institucionale.
- **VKM nr. 817/2005 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave për njoftimin e ndihmës shtetërore":** Ky akt përcaktoi formatet dhe afatet që institucionet dhënëse (ministritë, bashkitë) duhet të respektojnë për të njoftuar projektet e tyre të ndihmës pranë Komisionit.
- **Rregulloret e "De Minimis":** Janë miratuar rregullore të posaçme që përcaktojnë tavanet e ndihmës me vlerë të vogël (p.sh. deri në 200,000 euro për një ndërmarrje gjatë 3 viteve), të cilat nuk konsiderohen si ndihmë shtetërore që shtrembërojnë tregun.
- **Digjitalizimi i procesit:** Ngjashëm me reformën në QKB, edhe kontrolli i ndihmës ka nisur tranzicionin drejt regjistrimit elektronik. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian parashikon krijimin e një **Regjistri Digjital të Ndihmës Shtetërore**, për të mundësuar një monitorim në kohë reale të të gjitha subvencioneve të dhëna në nivel kombëtar.

Problemi në shqyrtim

1. *Përshkruani natyrën e problemit.*
2. *Identifikoni shkaqet e problemit.*
3. *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
4. *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
5. *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

1. Natyra e problemit

Problemi është institucional dhe rregullator dhe lidhet me nevojën për forcimin e garancive të pavarësisë operacionale dhe paanshmërisë së funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore, si

dhe të kapaciteteve administrative, teknike dhe hetimore për shqyrtimin, monitorimin dhe kontrollin efektiv të masave të ndihmës shtetërore. Kuadri aktual kërkon një ndarje më të qartë institucionale ndërmjet funksionit të kontrollit dhe autoriteteve publike që mund të veprojnë njëkohësisht si dhënëse të ndihmës shtetërore. Problemi lidhet edhe me nevojën për sigurimin e burimeve njerëzore, financiare dhe teknike të nevojshme për ushtrimin efektiv të këtyre funksioneve, si dhe me riorganizimin e brendshëm të Autoritetit të Konkurrencës për të mundësuar marrjen përsipër të funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore.

Kuadri ekzistues nuk përcakton në mënyrë të mjaftueshme mekanizma që sigurojnë autonomi institucionale dhe mbrojtje ndaj ndikimeve të mundshme administrative apo politike në procesin e vlerësimit dhe vendimmarrjes mbi skemat e ndihmës shtetërore.

Natyra e problemit është kryesisht rregullatore, pasi buron nga mungesa e harmonizimit të plotë të kuadrit ligjor me *acquis* të BE-së, veçanërisht sa i përket pavarësisë financiare dhe administrative të organit rregullator. Megjithatë, problemi ka edhe një dimension jorregullator, i lidhur me mungesën e kapaciteteve teknike dhe infrastrukturës IT për monitorimin e ndihmës në kohë reale dhe mungesën e ekspertizës së specializuar për analizat komplekse ekonomike të ndikimit në treg.

2. Shkaqet e problemit

- Mospërputhja Rregullatore: Ligji ekzistues është hartuar në vitin 2005 dhe nuk pasqyron zhvillimet e fundit të rregullave të BE-së (Modernizimi i Ndihmës Shtetërore - SAM), që kërkon procedura më strikte për ndihmën sektoriale.
- Varësia Institucionale: Struktura aktuale e Sekretariatit brenda ministrisë kufizon burimet njerëzore dhe autonominë vendimmarrëse.
- Mungesa e Infrastrukturës Digjitale: Mungesa e një sistemi të automatizuar raportimi bën që mbledhja e të dhënave nga bashkitë dhe ministritë linjë të bëhet manualisht, duke rritur mundësinë për gabime dhe mungesë transparence.

3. Shtrirja e problemit

Problemi ka një shtrirje mbarëkombëtare. Ai prek të gjithë sektorët e ekonomisë ku shteti ndërhyn përmes burimeve financiare, garancive apo lehtësive fiskale. Sipas të dhënave të fundit, vlera e ndihmës shtetërore në Shqipëri është rritur, por monitorimi i ndikimit të saj në konkurrencë mbetet i kufizuar. Kjo situatë pengon nxitjen e investimeve të huaja direkte (IHD), pasi investitorët potencialë hezitojnë të hyjnë në tregje ku rregullat e subvencionimit nuk janë transparente.

4. Grupet e prekura

- Qeveria (Qendrore dhe Lokale): Përballet me vështirësi në hartimin e skemave që janë në përputhje me BE-në dhe rrezikon penalitete gjatë procesit të integrimit.
- Biznesi: Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) preken më së shumti nga konkurrenca e padrejtë nëse ndërmarrje të mëdha apo strategjike marrin ndihmë të paautorizuar.

- Qytetarët/Taksapaguesit: Preken drejtpërdrejt pasi fondet publike mund të përdoren në mënyrë joefikase për të mbështetur kompani që nuk janë produktive, në vend që të investohen në shërbime publike.
- Shoqëria Civile dhe ekspertët e konkurrencës: Hasin vështirësi në monitorimin e transparencës për shkak të mungesës së të dhënave të hapura (open data).

5. Vlerësimi i trajtimit përmes ndryshimit të politikave

Ky problem mund të trajtohet vetëm përmes një ndryshimi rrënjësor të politikave dhe kuadrit ligjor. Nuk referohet te ketë masa administrative që mund të zëvendësojë nevojën për një ligj të ri që garanton:

1. Funksionimin e një Autoriteti të pavarur me buxhet të vetin.
2. Fuqi hetimore "on-site" (inspektime të papritura).
3. Detyrimin ligjor për funksionimin e Regjistrit Digjital të Ndihmës Shtetërore.

Pa këto ndryshime, Shqipëria rrezikon negociatat për Kapitullin 8 dhe vonon në arritjen e objektivit për anëtarësim në vitin 2030, pasi kontrolli i ndihmës shtetërore është një nga "benchmark-et" kryesore të integrimit në Tregun e Përbashkët.

Arsyeja e ndërhyrjes

6. Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.
7. Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.
8. Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.
9. Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.

Arsyeja për Ndërhyrje

Procesi i integrimit evropian të Shqipërisë kërkon që sistemi i kontrollit të ndihmës shtetërore të jetë plotësisht i pavarur dhe efektiv. Megjithëse Shqipëria ka një ligj ekzistues (Ligji nr. 9374/2005), përditësimi i acquis të BE-së, veçanërisht Direktiva (BE) 2019/1 (ECN+) dhe Rregulloret e Modernizimit të Ndihmës Shtetërore (SAM), diktojnë nevojën për një autoritet që nuk është thjesht një strukturë administrative brenda ministrisë, por një organ me autonomi financiare dhe vendimmarrëse.

Qeveria e konsideron të domosdoshme ndërhyrjen për të siguruar një ndarje më të qartë institucionale ndërmjet funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore dhe institucioneve publike që japin ndihmë shtetërore, si dhe për të garantuar ushtrimin e këtij funksioni në mënyrë të pavarur dhe të paanshme. Ndërhyrja është e nevojshme për të transferuar funksionin e kontrollit të ndihmës shtetërore pranë Autoritetit të Konkurrencës, për të forcuar kapacitetet administrative, teknike dhe hetimore, si dhe për të pajisur autoritetin me instrumentet e nevojshme për monitorimin, mbledhjen e informacionit, administrimin e regjistrit të ndihmës shtetërore dhe zbatimin efektiv të vendimeve. Gjithashtu, ndërhyrja synon të adresojë rekomandimet e përsëritura të Komisionit Evropian dhe angazhimet e Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit evropian, duke siguruar një sistem kontrolli më efektiv, transparent dhe në përputhje me acquis të Bashkimit Evropian.

Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje

Përmes kësaj nisme, Qeveria e Shqipërisë synon të:

- **Sigurojë Pavarësinë Institucionale:** Shndërrimin e organit mbikëqyrës në një autoritet të pavarur (brenda Autoritetit të Konkurrencës), duke shmangur konfliktin e interesit kur shteti është njëkohësisht "dhënës" dhe "kontrollues" i ndihmës.
- **Digjitalizojë Monitorimin:** Krijimin e Regjistrit Digjital të Ndihmës Shtetërore, duke eliminuar raportimin manual dhe duke mundësuar transparencë në kohë reale për çdo qindarkë publike të dhënë bizneseve.
- **Fuqizojë Sanksionet:** Dhënien e kompetencave për inspektime të drejtpërdrejta dhe vendosjen e gjobave ndaj institucioneve dhënëse që nuk njoftojnë skemat e ndihmës.
- **Reduktojë Burokracinë për NVM-të:** Thjeshtimin e procedurave për ndihmën e vogël (*De Minimis*) dhe skemat e përjashtimit sipas kategorive (GBER), duke lehtësuar qasjen e bizneseve të vogla në mbështetje financiare pa vonesa administrative.

Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë

Kjo ndërhyrje përbën një element të rëndësishëm të procesit të integrimit evropian të Shqipërisë dhe kontribuon drejtpërdrejt në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga acquis i Bashkimit Evropian në fushën e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore. Reforma mbështetet në dokumentet strategjike dhe programore të mëposhtme:

- **Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA)**: Neni 71 i MSA-së parashikon që ndihma shtetërore që shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën të kontrollohet sipas parimeve të Bashkimit Evropian. Forcimi i sistemit të kontrollit të ndihmës shtetërore dhe garantimi i pavarësisë funksionale të autoritetit përgjegjës përbëjnë elemente thelbësore për zbatimin efektiv të këtij detyrimi.
- **Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2025–2027**: Nisma kontribuon në përmbushjen e masave të parashikuara në kuadër të Kapitullit 8 "Politika e Konkurrencës", duke mbështetur përafrimin e mëtejshëm me acquis të BE-së, veçanërisht me rregullat procedurale dhe institucionale që lidhen me kontrollin efektiv të ndihmës shtetërore.
- **Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027 / Agjenda e Reformës për Bashkimin Evropian**: Forcimi i sistemit të kontrollit të ndihmës shtetërore konsiderohet pjesë e reformave prioritare për funksionimin e ekonomisë së tregut dhe përmirësimin e qeverisjes ekonomike. Një sistem më i pavarur, transparent dhe efektiv i kontrollit të ndihmës shtetërore kontribuon në krijimin e kushteve të barabarta të konkurrencës, përdorimin më eficient të fondeve publike, reduktimin e shtrembërimeve të tregut dhe rritjen e besimit të investitorëve vendas dhe të huaj.
- **State Aid Modernisation (SAM)**: Reforma është në përputhje me objektivat e iniciativës së Komisionit Evropian për Modernizimin e Ndihmës Shtetërore (State Aid Modernisation), e cila synon përqendrimin e kontrollit te masat me ndikim më të madh në konkurrencë dhe tregtinë, rritjen e efektivitetit të monitorimit, forcimin e transparencës dhe përdorimin më efikas të burimeve publike për të mbështetur rritjen ekonomike dhe konkurrueshmërinë. Forcimi i kompetencave monitoruese, hetimore

dhe të mbledhjes së informacionit, si dhe administrimi i regjistrit të ndihmës shtetërore, reflektojnë drejtpërdrejt parimet e kësaj reforme evropiane.

- **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHIE) 2022–2030**: Përmirësimi i sistemit të kontrollit të ndihmës shtetërore mbështet objektivin për zhvillimin e një ekonomie konkurruese, inovative dhe të orientuar drejt standardeve të Bashkimit Evropian, duke garantuar që fondet publike të përdoren në mënyrë transparente dhe të mos krijojnë avantazhe të padrejta në treg.
- **Agjenda Kombëtare e Digjitalizimit**: Nisma mbështet forcimin e transparencës dhe monitorimit përmes krijimit dhe administrimit të regjistrit të ndihmës shtetërore, duke kontribuar në digjitalizimin e proceseve administrative dhe përmirësimin e mbledhjes, përpunimit dhe raportimit të të dhënave në përputhje me praktikat e BE-së.

9. Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë

Deri më tani janë bërë hapa pozitive që shërbejnë si bazë për këtë reformë:

- **Krijimi dhe funksionimi i strukturës kombëtare të kontrollit të ndihmës shtetërore.** Është ngritur dhe funksionalizuar struktura përgjegjëse për kontrollin e ndihmës shtetërore (Sekretariati/Komisioni i Ndihmës Shtetërore) si organ i ngarkuar me vlerësimin ex-ante të masave të ndihmës dhe monitorimin e tyre në nivel kombëtar. Eshte kryer nje proces i pjesshem i perafrimit te kuadrit rregullaotor me Acquis dhe standardet e BE-së (te jepet informacion se cfare eshte bere deri me tani ne kete drejtim). Çështja e ndihmës shtetërore është integruar si prioritet në:

– ERP (Economic Reform Programme),

– PKIE (Plani Kombëtar për Integrimin Evropian),

– dhe dialogun ekonomik me BE-në,

– si pjesë e kërkesës për funksionimin e një ekonomie tregu funksionale.

- **Certifikimi dhe Analiza:** Është kryer Vlerësimi i Boshllëqeve Legjislative (LGA) për Kapitullin 8, i cili ka identifikuar pikat ku ligji i vitit 2005 nuk përputhet më me standardet e reja të BE-së.
- **Kapacitetet Teknike:** Sekretariati aktual ka marrë trajnime nga asistenca teknike e BE-së (projekte si CARDS, TAIEX dhe IPA) për metodologjinë e vlerësimit të ndihmës në sektorë kompleksë si energjia dhe transporti.Nëpërmjet asistencës teknike është hartuar ligji nr. 9374/2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar dhe aktet nënëligjore si edhe trajnimi i stafit përmes seminareve të TAIEX, expert missions dhe study visits.
- **Regjistri Fillestar:** Është krijuar një bazë të dhënash e thjeshtë për inventarin e skemave ekzistuese, e cila shërben si pikënisje për Regjistrin Digjital të integruar.Raportet vjetore të ndihmës janë hartuar mbi bazën e vendimeve të Komisionit të Ndihmës Shtetërore dhe e gjithë databaza ka nevojë të transferohet në format elektronik në të cilin mund të kenë akses dhenësit e ndihmës për të njoftuar skemat e reja të ndihmës si edhe raportuar zbatimin e skemës së ndihmës shtetërore.

- **Bashkëpunimi me partnërë për zhvillim:** Janë zhvilluar tryeza konsultimi me grupe interesi dhe ekspertë ndërkombëtarë për të hartuar modelin e ri të autoritetit të pavarur, duke marrë si referencë modelet më të suksesshme të vendeve anëtare të BE-së.

Ndërhyrja konsiderohet urgjente, pasi mosveprimi do të çonte në mbetjen prapa të Shqipërisë në raport me vendet e rajonit dhe do të penalizonte bizneset vendase që kërkojnë të operojnë në tregun unik evropian.

Objektivi i politikës

1. *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
2. *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
3. *Sigurohuni që objektivat janë specifikë, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivi i politikës

Objektivat e harmonizimit të legjislacionit për ndihmën shtetërore me *acquis* të BE-së dhe forcimit të pavarësisë institucionale janë si vijon:

- Sigurimi i përputhshmërisë me Rregulloren (BE) 2015/1589 dhe Direktivën ECN+,
- Forcimi i mekanizmave të monitorimit dhe kontrollit të ndihmës shtetërore deri në vitin 2028, duke siguruar verifikimin periodik të zbatimit të skemave dhe raportimin vjetor të tyre.
- Ulja e rasteve të ndihmës shtetërore të paautorizuar deri në fund të vitit 2028, përmes forcimit të procedurave të njoftimit paraprak dhe monitorimit institucional.

Ky objektiv synon të lehtësojë mbylljen e negociatave teknike për Kapitullin 8 deri në vitin 2027 dhe të përmbushë kriteret e anëtarësimit deri në vitin 2030.

- **Transferimi i funksionit të ndihmës shtetërore pranë Autoritetit të Konkurrencës** brenda vitit 2026, duke siguruar autonomi financiare dhe administrative nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, me një strukturë të dedikuar që garanton paanësinë në vendimmarrje.
- **Funksionalizimi i Regjistrit Digjital të Ndihmës Shtetërore** deri në dhjetor 2027. Sistemi do të mundësojë shkëmbimin e automatizuar të të dhënave me institucionet dhënëse (ministritë/bashkitë) dhe publikimin e çdo skeme ndihme brenda 10 ditëve nga aprovimi, duke rritur transparencën me 100%.
- **Rritja e efikasitetit të rikuperimit të ndihmës së paligjshme**, duke synuar që brenda vitit 2027, të paktën 90% e vendimeve për rikuperim të ekzekutohen brenda afateve ligjore, duke reduktuar kështu deformimet e konkurrencës në treg.
- Digjitalizimi i procesit të njoftimit dhe monitorimit të ndihmës shtetërore deri në fund të vitit 2027, duke mundësuar që 100% e aplikimeve për autorizim të kryhen online dhe duke ulur kohën e shqyrtimit administrativ me 40%.

Të gjithë këta objektiva janë formuluar në mënyrë specifike, të matshme, të arritshme, realiste dhe të kufizuara në kohë (**SMART**).

- **Specifikë:** Objektivat lidhen me veprime konkrete dhe të identifikueshme, si: kalimi i statusit të Komisionit në Autoritet të pavarur, krijimi i Regjistrit Digjital dhe transpozimi i Rregullores (BE) 2015/1589. Secili objektiv adreson drejtpërdrejt shkaqet e problemit (varësia institucionale dhe mungesa e transparencës).
- **Të Matshëm:** Janë përcaktuar tregues sasiorë të qartë, si: miratimi i ligjit deri në fund të 2026, matja e ekzekutimit të vendimeve të rikuperimit në 90%, dhe reduktimi i kohës administrative me 40%. Progresi do të matet përmes raporteve vjetore të monitorimit që i dërgohen Kuvendit dhe Komisionit Evropian.
- **Të Arritshëm:** Objektivat bazohen në infrastrukturën ekzistuese të administratës publike dhe mbështeten nga asistenca teknike e huaj (p.sh. projekte IPA). Ngritja e një autoriteti të pavarur është një proces i testuar tashmë me institucione si Autoriteti i Konkurrencës.
- **Realë:** Afatet dhe synimet janë të moderuara dhe bazohen në përvojën e vendeve të rajonit që kanë mbyllur Kapitullin 8. Ato marrin parasysh burimet njerëzore ekzistuese dhe nevojën për trajnim të specializuar të stafit të ri.
- **Të Kohëzuar:** Secili objektiv ka një afat: ligji (2025), autoriteti (qershor 2026), regjistri (dhjetor 2027) dhe rezultatet e para të performancës (2027). Kjo linjë kohore është në harmoni të plotë me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE).

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

1. *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
2. *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
3. *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

Opsioni 0 (Status quo)

Ky opsion nënkupton vijimin me kuadrin aktual ligjor (**Ligji nr. 9374/2005**) dhe strukturën ekzistuese institucionale. Në këtë skenar, Komisioni i Ndihmës Shtetërore (KNSH) do të vazhdonte të operonte me një Sekretariat që është pjesë organike e ministrisë, pa autonomi financiare dhe pa mjete të forta hetimore. Ky opsion nuk ka kosto te shtuara afatshkurtra ne buxhet dhe nuk kerkon burime njerezore per ndermarrjen e masave te caktuara, por siguron vazhdimësi institucionale dhe shmang ndërprerjet operacionale gjatë periudhës së tranzicionit, duke ruajtur funksionimin aktual të skemës së ndihmës shtetërore pa nevojën e ristrukturimeve të menjëhershme organizative.

Pse nuk është i përshtatshëm:

- Detyrimet e MSA-së: Neni 71 i MSA-së kërkon një organ “operacionalisht të pavarur”. Status quo-ja aktuale është kritikuar në raportet e progresit të BE-së si e pamjaftueshme.
- Risku për arritjen e objektivit 2030: Pa këtë reformë, Kapitulli 8 nuk mund të mbyllet, duke bllokuar anëtarësimin e Shqipërisë në BE.

- Pasiguria për biznesin: Mungesa e një regjistri digjital transparent mban kosto të larta administrative dhe rrezikon dhënien e ndihmës së paligjshme që mund të duhet të rikuperohet më vonë nga vetë bizneset.

Opsionin 1 (Krijimi i një autoriteti të ri të pavarur të kontrollit të ndihmës shtetërore)

Ky opsion parashikon krijimin e një institucioni të ri publik, të dedikuar ekskluzivisht funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore, me kompetenca të plota vendimmarrëse, monitoruese, hetimore dhe sanksionuese. Institucioni i ri do të kishte strukturat e veta administrative, buxhetin e dedikuar dhe kapacitetet e nevojshme për ushtrimin në mënyrë të pavarur të funksioneve të kontrollit të ndihmës shtetërore.

Avantazhet:

- **Pavarësi institucionale e lartë:** Siguron ndarje të plotë institucionale ndërmjet funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore dhe autoriteteve publike që japin ndihmë shtetërore.
- **Specializim i dedikuar:** Mundëson krijimin e strukturave dhe ekspertizës së specializuar ekskluzivisht për kontrollin e ndihmës shtetërore.
- **Autonomi organizative dhe buxhetore:** Lehtëson ndërtimin e procedurave, prioriteteve dhe burimeve të dedikuara për ushtrimin e kompetencave në këtë fushë.

Disavantazhet:

- Kosto të larta financiare dhe administrative: Kërkon krijimin e një institucioni të ri publik, ngritjen e strukturave të reja organizative, personelit, infrastrukturës dhe sistemeve mbështetëse.
- Periudhë më e gjatë tranzicioni: Operacionalizimi i plotë i institucionit të ri do të kërkonte kohë shtesë për rekrutimin e stafit, miratimin e strukturave dhe krijimin e kapaciteteve të nevojshme.
- Mbivendosje e mundshme institucionale: Ekziston rreziku i krijimit të funksioneve paralele me ato të Autoritetit të Konkurrencës dhe i rritjes së fragmentimit institucional në fushën e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore.
- Kosto më të larta afatgjata të funksionimit: Kërkon financim të vazhdueshëm për administratën, pajisjet, sistemet e informacionit dhe strukturat drejtuese të institucionit të ri.

Opsioni 2- (Ndryshimi i ligjit ekzistues dhe transferimi i funksionit te Autoriteti i Konkurrencës) – Opsioni i preferuar: Ky opsion parashikon transferimin e funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe përcaktimin e Komisionit të Konkurrencës si organ vendimmarrës, duke garantuar forcimin e pavarësisë funksionale, kapaciteteve administrative dhe instrumenteve të zbatimit.

Avantazhet:

- Garantimi i pavarësisë funksionale: Transferimi i funksionit te Autoriteti i Konkurrencës mundëson ushtrimin e kontrollit të ndihmës shtetërore nga një institucion i pavarur, duke shmangur varësinë nga strukturat e ministrisë.
- Përdorimi i kapaciteteve institucionale ekzistuese: Shfrytëzon ekspertizën, përvojën, burimet njerëzore dhe kapacitetet administrative të Autoritetit të Konkurrencës, duke shmangur ngritjen e një institucioni të ri.

- Kosto më të ulëta financiare dhe administrative: Kufizon kostot që lidhen me krijimin e strukturave të reja drejtuese, administrative dhe infrastrukturore.
- Forcimi i mekanizmave të kontrollit dhe zbatimit: Mundëson përdorimin e instrumenteve hetimore, monitoruese dhe vendimmarrëse të një institucioni me përvojë në zbatimin e rregullave të konkurrencës.
- Përmirësimi i koordinimit institucional: Krijon mundësi për sinergji ndërmjet politikave të konkurrencës dhe kontrollit të ndihmës shtetërore.
- Përputhshmëri më e mirë me kërkesat e BE-së: Krijon kushte më të përshtatshme për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga MSA-ja dhe acquis i BE-së në fushën e kontrollit të ndihmës shtetërore.

Disavantazhet:
- Kosto fillestare për përshtatjen institucionale: Kërkon ndryshime në organizimin e brendshëm, rishpërndarjen e burimeve njerëzore dhe sigurimin e kapaciteteve shtesë për ushtrimin e funksionit të ri.
- Nevoja për ndryshime ligjore dhe nënligjore: Transferimi i kompetencave kërkon rishikimin e kuadrit ligjor ekzistues dhe përshtatjen e akteve nënligjore, rregulloreve dhe procedurave përkatëse.
- Rreziku i mbingarkesës institucionale: Shtimi i funksioneve të kontrollit të ndihmës shtetërore mund të rrisë ngarkesën administrative dhe operative të Autoritetit të Konkurrencës.
- Nevoja për ekspertizë të specializuar: Kontrolli i ndihmës shtetërore kërkon njohuri specifike mbi rregullat e BE-së, të cilat mund të kërkojnë trajnime dhe rekrutim të personelit të specializuar.
- Periudhë tranzicioni: Transferimi i funksionit kërkon masa për kalimin e dosjeve, të dhënave, procedurave dhe përgjegjësive nga struktura aktuale te Autoriteti i Konkurrencës, duke shmangur ndërprerjen e veprimtarisë.

Ky opsion paraqitet si alternativa më proporcionale, pasi kombinon pavarësinë institucionale dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit me përdorimin e kapaciteteve ekzistuese, duke kufizuar kostot dhe kohën e nevojshme për zbatimin e reformës. Megjithatë, në RIA duhet të argumentohet se kapacitetet aktuale të Autoritetit të Konkurrencës janë të mjaftueshme ose mund të plotësohen me burime shtesë për të përballuar funksionin e ri.
Ky opsion parashikon shfuqizimin e ligjit të vitit 2005 dhe miratimin e një kornize krejtësisht të re, që krijon Autoritetin e Ndihmës Shtetërore si një entitet rregullator të ngjashëm me Autoritetin e Konkurrencës.

Opsioni 3 – Jorregullator. Përmirësimi i mekanizmave të zbatimit dhe forcimi i kapaciteteve të strukturës ekzistuese të kontrollit të ndihmës shtetërore.

Ky opsion parashikon përmirësimin e funksionimit të sistemit aktual të kontrollit të ndihmës shtetërore, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve administrative dhe profesionale të Sekretariatit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, pa ndryshuar kuadrin ligjor dhe strukturën institucionale ekzistuese. Ndërhyrja do të fokusohej në rritjen e kapaciteteve të stafit përmes trajnimeve të specializuara, përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional me ministritë dhe institucionet që japin ndihmë shtetërore, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit të tyre për detyrimin e njoftimit paraprak të skemave të ndihmës shtetërore.
Gjithashtu, ky opsion do të përfshinte përmirësimin e praktikave të monitorimit të skemave ekzistuese, hartimin e udhëzuesve metodologjikë për institucionet dhënëse të ndihmës shtetërore, zhvillimin e një mekanizmi të centralizuar për mbledhjen dhe administrimin e

informacionit mbi ndihmën shtetërore, si dhe publikimin sistematik të të dhënave për të rritur transparencën ndaj bizneseve dhe publikut.

Avantazhet:

- Kosto më të ulëta financiare dhe administrative krahasuar me krijimin e një institucioni të ri.
- Mundësi për zbatim më të shpejtë, duke shfrytëzuar strukturat dhe burimet ekzistuese.
- Rritje e ekspertizës dhe kapaciteteve profesionale të stafit përgjegjës.
- Përmirësim i koordinimit dhe komunikimit me institucionet dhënëse të ndihmës shtetërore.
- Rritje e transparencës dhe ndërgjegjësimit të institucioneve dhe bizneseve për rregullat e ndihmës shtetërore.

Disavantazhet:

- Ndikim i kufizuar në adresimin e problematikës së pavarësisë operacionale të Komisionit të Ndihmës Shtetërore.
- Përmirësimet varen nga gatishmëria dhe bashkëpunimi i institucioneve dhënëse të ndihmës shtetërore.
- Nuk garanton zgjidhjen e problematikave strukturore që lidhen me organizimin dhe pozicionimin institucional të Sekretariatit.
- Përmirësimi i kapaciteteve dhe procedurave nuk mund të zëvendësojë garancitë ligjore dhe institucionale të pavarësisë.

Si janë identifikuar opsionet e politikës?

Opsionet janë identifikuar përmes një procesi teknik dhe konsultativ:

1. **Analiza e Boshllëqeve (LGA):** Ekspertët e Kapitullit 8 identifikuan mospërputhjet mes ligjit shqiptar dhe rregullave të BE-së.
2. **Rekomandimet e Komisionit Evropian:** Raportet e Progresit (2023-2026) kanë qenë udhërrëfyesi kryesor për nevojën e pavarësisë institucionale.
3. **Benchmarking me Rajonin:** Janë studiuar modelet e vendeve si Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut, të cilat kanë kaluar nëpër reforma të ngjashme për Kapitullin 8.
4. **Asistenca Teknike:** Konsultimet me partnerët ndërkombëtarë ndihmuan në vlerësimin e kostove dhe përfitimeve të secilit opsion.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

a) Identifikoni grupet e prekura.

b) Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.

c) Për ndikimet e drejtpërdrejta:

a. *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
b. *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
c. *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
d. *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*

d) *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
   a. *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
   b. *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*

e) *Diskutoni kufizimin e analizës:*
   a. *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
   b. *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*

f) *Përmblidhni vlerësimin e opsioneve:*
   a. *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
   b. *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
   c. *Paraqisni përllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Grupet e prekura nga Opsioni 2

- Institucionet dhënëse të ndihmës: Ministritë, Bashkitë, dhe agjencitë qeveritare që menaxhojnë fonde publike.

- Ndërmarrjet përfituese: Kompanitë private, përfshirë NVM-të dhe startup-et, që përfitojnë grante, garanci sovrane apo lehtësi fiskale. Reforma pritet të ndikojë drejtpërdrejt te ndërmarrjet dhe përfituesit e ndihmës shtetërore përmes forcimit të mekanizmave të monitorimit, raportimit dhe zbatimit të rregullave të ndihmës shtetërore. Ndërmarrjet do të kenë detyrime më të qarta për dhënien e informacionit dhe për respektimin e kërkesave

procedurale të parashikuara në ligj. Në të njëjtën kohë, pritet rritje e transparencës, parashikueshmërisë dhe sigurisë juridike në zbatimin e masave të ndihmës shtetërore.

- Autoriteti i Konkurrencës: Komisioni dhe Sekretariati që do të zgjerojnë fushën e veprimtarisë.
- Investitorët e huaj: Që kërkojnë kushte të barabarta konkurrence (level playing field).
- Institucionet mbështetëse: AKSHI (për regjistrin digjital), Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit.
- Publiku dhe Media: Që përfitojnë nga transparenca e përdorimit të burimeve shtetërore.
- **Sistemi gjyqësor:** Forcimi i kuadrit institucional dhe procedural të kontrollit të ndihmës shtetërore mund të sjellë një rritje të rasteve të shqyrtimit gjyqësor të vendimeve administrative të marra në këtë fushë. Si rrjedhojë, mund të lindë nevoja për konsolidimin e praktikës gjyqësore dhe forcimin e kapaciteteve profesionale në fushën e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore.

Llojet e ndikimeve sipas grupeve të prekura

1. Ndikimet e drejtpërdrejta

a. Përshkrimi cilësor

- Institucionet dhënëse: Do të kenë detyrimin ligjor për njoftimin (notification) paraprak të çdo skeme ndihme përmes sistemit digjital, duke eliminuar mundësinë e ndihmës së paligjshme.
- Ndërmarrjet (NVM-të): Do të përfitojnë nga rregulla më të qarta për ndihmën *De Minimis* dhe skemat e përjashtimit bllok (GBER), duke marrë mbështetje më shpejt dhe pa burokraci.
- Autoriteti i Konkurrencës: Do të zgjerojë fuqi hetimore (inspektime në terren) dhe për të urdhëruar edhe rikuperimin e ndihmës nëse konstatohen shkelje.

b. Analizë sasiore dhe cilësore

- **Efektiviteti institucional:** Transferimi i funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore pranë Autoritetit të Konkurrencës pritet të forcojë pavarësinë operacionale, paanshmërinë dhe efektivitetin e procesit të shqyrtimit, monitorimit dhe kontrollit të masave të ndihmës shtetërore.
- **Monitorimi dhe transparenca:** Projektligji forcon mekanizmat e mbledhjes dhe administrimit të të dhënave, monitorimit të zbatimit të vendimeve dhe administrimit të

regjistrit të ndihmës shtetërore, duke rritur transparencën dhe gjurmueshmërinë e masave të ndihmës shtetërore.

- **Kapacitetet administrative:** Reforma kërkon forcimin e kapaciteteve administrative, teknike dhe hetimore pranë Autoritetit të Konkurrencës, si dhe sigurimin e burimeve njerëzore, financiare dhe teknike të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të reja.
- **Ndikimi financiar:** Efektet buxhetore lidhen kryesisht me transferimin e funksioneve, përshtatjen e strukturës organizative dhe sigurimin e burimeve të nevojshme për zbatimin e reformës. Në këtë fazë, kostot nuk janë kuantifikuar dhe do të vlerësohen në kuadër të procesit të zbatimit dhe të planifikimit buxhetor afatmesëm.

2. Ndikimet e tërthorta

a. Përshkrimi cilësor

- Klima e Biznesit: Harmonizimi me BE-në rrit besueshmërinë e Shqipërisë te investitorët strategjikë, duke ditur se shteti nuk mbështet në mënyrë të padrejtë konkurrentët e tyre.

- Konkurrenca: Reduktohet avantazhi i padrejtë i kompanive që mbijetojnë vetëm përmes subvencioneve shtetërore, duke nxitur inovacionin.

- Integrimi në BE: Përmbushja e kritereve të Kapitullit 8 mundëson avancimin e Shqipërisë drejt mbylljes së grup-kapitujve të parë.

b. Ndikimi mbi konkurrencën

Reforma eliminon fragmentimin e tregut. Duke vendosur kritere strikte për ndihmën, shteti siguron që fondet publike të shkojnë për dështimet e tregut (p.sh. kërkim-zhvillim, mjedis) dhe jo për të mbajtur artificialisht në treg kompani jo-efiçente. Kjo rrit eficencën e shpërndarjes së burimeve shtetërore në ekonominë shqiptare.

Kufizimet e analizës

- Risqet: Mundësia e mungesës së njoftimit nga organet e vetëqeverisjes vendore (bashkitë) për të raportuar skemat e tyre të vogla të ndihmës.

- Faktorët pengues: Vonesat në ndërlidhjen e bazave të të dhënave mes Autoritetit dhe AKSHI-t mund të shtyjnë funksionalizimin e plotë të regjistrit.

- Supozime: Analiza supozon një vullnet të fortë politik për të rikuperuar ndihmën e paligjshme, edhe kur përfituesit janë subjekte me ndikim.

PPwrmbledhje tw opsionit

Opsioni	Ndikimi cilësor	Kostot / Përfitimet
Opsioni 0 - Status quo	Nuk adreson nevojën për forcimin e pavarësisë operacionale, kapaciteteve administrative dhe instrumenteve të kontrollit të ndihmës shtetërore.	Nuk krijon kosto shtesë financiare në afat të shkurtër, por sjell kosto institucionale dhe rrezik për vonesa

	Mangësitë e identifikuara nga Komisioni Evropian mbeten të pazgjidhura.	në përmbushjen e detyrimeve të procesit të integrimit evropian.
Opsioni 1 - Krijimi i një autorit	Siguron nivel të lartë të pavarësisë institucionale dhe specializim të dedikuar për kontrollin e ndihmës shtetërore.	Kërkon krijimin e një institucioni të ri publik, personel shtesë, strukturë organizative, buxhet dhe infrastrukturë të re. Kosto të larta financiare dhe administrative, si dhe periudhë më të gjatë tranzicioni.
Opsioni 2	Forcon pavarësinë operacionale, paanshmërinë dhe efektivitetin e kontrollit të ndihmës shtetërore, duke përdorur kapacitetet e një institucioni ekzistues të pavarur. Mundëson përafrim më të mirë me acquis të BE-së dhe forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe zbatimit.	Kërkon përshtatje organizative, transferim të funksioneve dhe forcim të kapaciteteve administrative, me kosto më të ulëta se krijimi i një institucioni të ri.
Opsioni 3	Mundëson përmirësimin e kapaciteteve profesionale dhe administrative të Sekretariatit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, rritjen e koordinimit ndërinstitucional, përmirësimin e monitorimit dhe transparencës përmes udhëzuesve metodologjikë dhe mjeteve digjitale. Megjithatë, nuk adreson problematikën e pavarësisë operacionale dhe kufizimet strukturore të sistemit aktual të kontrollit të ndihmës shtetërore.	Nuk kërkon ndryshime ligjore apo krijimin e strukturave të reja institucionale dhe mund të realizohet duke përdorur burimet ekzistuese, duke kufizuar kostot financiare. Përfshin kosto për trajnimin e stafit, zhvillimin e mjeteve digjitale dhe përmirësimin e mekanizmave të monitorimit dhe koordinimit. Përfitimet mbeten të kufizuara, pasi masat nuk garantojnë përmbushjen e kërkesave të BE-së për pavarësinë operacionale të organit të kontrollit të ndihmës shtetërore.

Përfundim

Opsioni 2 mbetet zgjedhja më e përshtatshme, pasi realizon objektivat e reformës për forcimin e pavarësisë operacionale, kapaciteteve administrative dhe efektivitetit të kontrollit të ndihmës shtetërore, duke përdorur strukturat ekzistuese të Autoritetit të Konkurrencës dhe duke shmangur kostot financiare dhe administrative që do të sillte krijimi i një institucioni të ri publik. Ky opsion ofron balancën më të mirë ndërmjet efektivitetit institucional, përmbushjes së kërkesave të acquis të Bashkimit Evropian dhe përdorimit racional të burimeve publike.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

1. *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
2. *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Analiza me shumë kritere

Duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e kostove dhe përfitimeve që lidhen me reformën institucionale të kontrollit të ndihmës shtetërore nuk mund të kuantifikohen me saktësi në terma monetarë, analiza me shumë kritere është konsideruar metoda më e përshtatshme për vlerësimin krahasues të opsioneve të shqyrtuara.

Kriteret e vlerësimit janë përcaktuar në funksion të objektivave të reformës, duke marrë në konsideratë forcimin e pavarësisë operacionale dhe paanshmërisë së kontrollit të ndihmës shtetërore, efektivitetin institucional, kapacitetet administrative, efikasitetin në përdorimin e burimeve publike dhe përafrimin me acquis të Bashkimit Evropian.

Kriteret janë vlerësuar në një shkallë nga 0 deri në 4, ku 0 tregon mungesë kontributi në përmbushjen e kriterit dhe 4 kontributin më të lartë. Vlerësimi për secilin kriter shumëzohet me peshën përkatëse.

Kriteri	Pesha	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2		Opsioni 3
Pavarësia dhe paanshmëria institucionale	4	0 (0)	4 (16)	3 (12)		0 (0)
Efektiviteti i kontrollit, hetimit, monitorimit dhe vendimmarrjes	4	1 (4)	3 (12)	4 (16)		24 (8)
Kapacitetet administrative, njerëzore, financiare dhe teknike	3	1 (3)	2 (6)	4 (12)		3 (9)
Efikasiteti institucional dhe përdorimi i strukturave ekzistuese	3	2 (6)	1 (3)	4 (12)		3 (9)
Përafrimi me acquis dhe angazhimet e integrimit evropian	4	0 (0)	3 (12)	4 (16)		0 (0)
Kosto-efektiviteti dhe zbatueshmëria e ndërhyrjes	3	1 (3)	2 (6)	4 (12)		2 (6)
Gjithsej		16	55	80		32

Rezultati i analizës

Nga analiza krahasuese e kryer mbi bazën e kritereve dhe peshave të përcaktuara më sipër, Opsioni 2, i cili parashikon transferimin e funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore te Autoriteti i Konkurrencës dhe ushtrimin e kompetencave vendimmarrëse nga Komisioni i Konkurrencës, rezulton opsioni me vlerësimin më të lartë, me 80 pikë, krahasuar me 55 pikë për Opsionin 1,16 pikë për Opsionin 0 dhe 32 pikw pwr Opsionin 3.

Opsioni 2 siguron një balancë më të mirë ndërmjet forcimit të pavarësisë operacionale dhe efektivitetit të kontrollit të ndihmës shtetërore, përdorimit të strukturave ekzistuese institucionale, sigurimit të kapaciteteve administrative dhe përmbushjes së kërkesave të acquis të Bashkimit Evropian. Në të njëjtën kohë, ai shmang kostot e larta financiare, administrative dhe organizative që do të sillte krijimi i një institucioni të ri publik dhe ofron realizueshmëri më të lartë në zbatim.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

Pas vlerësimit të alternativave të mundshme dhe analizës së ndikimeve institucionale, administrative dhe financiare, opsioni i preferuar është Opsioni 2, i cili konsiston në ndryshimin

e ligjit ekzistues dhe transferimin e funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore te Autoriteti i Konkurrencës.

Ky opsion u vlerësua si zgjidhja më efektive dhe proporcionale për adresimin e problematikave të identifikuara, pasi mundëson forcimin e pavarësisë operacionale dhe paanshmërisë së funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore, duke përdorur kapacitetet dhe përvojën e një institucioni ekzistues të pavarur. Njëkohësisht, ai siguron përafrimin e mëtejshëm me acquis të Bashkimit Evropian dhe përmbushjen e rekomandimeve të Komisionit Evropian në fushën e ndihmës shtetërore, pa krijuar nevojën për ngritjen e një institucioni të ri publik.

Për të arritur këto objektiva, projektligji parashikon:

- transferimin e funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore pranë Autoritetit të Konkurrencës;
- përcaktimin e Komisionit të Konkurrencës si organ vendimmarrës në fushën e ndihmës shtetërore;
- forcimin e kapaciteteve administrative, teknike, hetimore dhe monitoruese për ushtrimin efektiv të funksioneve të kontrollit;
- forcimin e instrumenteve të monitorimit, mbledhjes dhe administrimit të të dhënave, si dhe të regjistrit të ndihmës shtetërore;
- forcimin e mekanizmave të zbatimit, duke përfshirë instrumentet procedurale dhe sanksionet administrative të parashikuara nga ligji;
- zgjerimin e fushës së zbatimit të kontrollit të ndihmës shtetërore edhe në sektorët e bujqësisë dhe peshkimit, në përputhje me acquis të Bashkimit Evropian.

Pse u zgjodh Opsioni 2?

Gjatë analizës së opsioneve, Opsioni 2 rezultoi më i favorshmi për arsyet e mëposhtme:

- **Efektivitet institucional:** siguron një ndarje më të qartë ndërmjet funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore dhe autoriteteve publike që japin ndihmë shtetërore, duke forcuar garancitë e pavarësisë operacionale dhe paanshmërisë.
- **Përafrim me acquis të BE-së:** mundëson forcimin e kuadrit institucional dhe procedural në përputhje me kërkesat e acquis të Bashkimit Evropian dhe rekomandimet e Komisionit Evropian.
- **Shfrytëzimi i kapaciteteve ekzistuese:** mbështetet në strukturat, përvojën institucionale dhe ekspertizën e Autoritetit të Konkurrencës, duke shmangur krijimin e strukturave paralele.
- **Efikasitet financiar dhe administrativ:** realizon objektivat e reformës me kosto më të ulëta krahasuar me krijimin e një autoriteti të ri të pavarur, duke kufizuar nevojat për personel, infrastrukturë dhe burime shtesë financiare.
- **Realizueshmëri më e lartë:** mundëson zbatimin më të shpejtë të reformës përmes transferimit të funksioneve dhe riorganizimit institucional, pa nevojën e ngritjes nga e para të një institucioni të ri publik.

Çështje të zbatimit

1. *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
2. *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
3. *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Zbatimi dhe monitorimi i opsionit të zgjedhur

Për zbatimin me sukses të Opsionit 1 (amendimet në ligjin aktual për Ndihmën Shtetërore), nevojitet përcaktimi i një arkitekture të qartë institucionale që garanton pavarësinë operative. Më poshtë paraqiten aktorët kyç dhe roli i tyre:

- **Ministria përgjegjëse për Ekonominë dhe Inovacionin (MEI):** Si autoriteti që udhëheq politikën e zhvillimit ekonomik, MEI do të ketë rol koordinues në fazën fillestare dëri në ngritjen e Autoritetit. Detyra kryesore është hartimi i projekligjit për ngritjen e Autoritetit.

- **Autoriteti i Konkurrencës:** Me hyrjen në fuqi të ligjit, Autoriteti i Konkurrencës do të marrë përsipër funksionin e kontrollit të ndihmës shtetërore dhe do të jetë përgjegjës për ushtrimin e funksioneve administrative, teknike, hetimore dhe monitoruese në këtë fushë. Nëpërmjet strukturës përgjegjëse për ndihmën shtetërore, Autoriteti do të shqyrtojë njoftimet e masave të ndihmës shtetërore, do të mbledhë dhe verifikojë informacionin e nevojshëm, do të monitorojë zbatimin e vendimeve dhe do të administrojë regjistrin e ndihmës shtetërore. Autoriteti do të sigurojë gjithashtu ndjekjen e procedurave për pezullimin, ndryshimin ose rikuperimin e ndihmës së paligjshme ose të papajtueshme, në përputhje me kompetencat e parashikuara në ligj.

- .

- **Ministria përgjegjëse për Financat:** Luan rolin e kontrollit të stabilitetit makroekonomikë. Ministria do të sigurojë që çdo skemë ndihme e propozuar nga institucionet publike të ketë mbulimin e nevojshëm buxhetor dhe të mos cenojë balancat fiskale. Gjithashtu, MF do të alokojë fondet e nevojshme për funksionimin e pavarur të Autoritetit dhe për zhvillimin e modulit teknologjik të Regjistrit të Ndihmës.

- **Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI):** Do të jetë inistitucioni teknik në ndërtimin e Regjistrit Digjital të Ndihmës Shtetërore. Ky regjistër do të shërbejë si një "pasaportë" për çdo grant apo lehtësi fiskale të dhënë në Shqipëri. AKSHI do të sigurojë ndërveprueshmërinë e këtij regjistri me sistemet e tjera shtetërore (si regjistri i tatimpaguesve dhe QKB) për të parandaluar tejkalimin e tavanit të ndihmës për të njëjtën ndërmarrje.

Mekanizmat e zbatimit dhe kapacitetet

Zbatimi i ligjit do të realizohet nëpërmjet strukturës së dedikuar për kontrollin e ndihmës shtetërore pranë Autoritetit të Konkurrencës, me Komisionin e Konkurrencës si organ vendimmarrës. Struktura përgjegjëse do të ushtrojë kompetencat administrative, hetimore, monitoruese dhe mbështetëse, duke përfshirë shqyrtimin e masave të ndihmës shtetërore, kryerjen e hetimeve administrative, administrimin e informacionit dhe monitorimin e zbatimit të vendimeve.

Për zbatimin efektiv të ligjit parashikohen:

1. **Kompetenca hetimore dhe të zbatimit**: Struktura përgjegjëse do të ketë të drejtën të kërkojë informacion nga institucionet publike, ndërmarrjet dhe grupimet e ndërmarrjeve, të kryejë verifikime dhe hetime administrative, si dhe të propozojë marrjen e masave sipas ligjit.

2. **Ekzekutimi i vendimeve**: Komisioni i Konkurrencës do të vendosë për pezullimin, ndryshimin, rikuperimin ose kthimin e ndihmës së paligjshme ose të papajtueshme. Institucionet dhënëse të ndihmës shtetërore janë të detyruara të zbatojnë vendimet përkatëse, ndërsa moszbatimi trajtohet sipas procedurave dhe mekanizmave të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

3. **Sanksionet administrative**: Projektligji parashikon vendosjen e gjobave dhe masave administrative ndaj ndërmarrjeve ose grupimeve të ndërmarrjeve në rast të mosdhënies, vonesës ose dhënies së informacionit të pasaktë, në përputhje me dispozitat e legjislacionit për mbrojtjen e konkurrencës, për aq sa janë të zbatueshme.

4. **Regjistri i ndihmës shtetërore**: Struktura përgjegjëse pranë Autoritetit të Konkurrencës do të krijojë, administrojë dhe përditësojë regjistrin e ndihmës shtetërore, mbi bazën e informacionit të raportuar nga institucionet publike dhënëse të ndihmës. Institucionet përgjegjëse do të kenë detyrimin ligjor për raportimin e të dhënave sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara.

5. **Koordinimi ndërinstitucional**: Do të krijohet një rrjet i përhershëm pikash kontakti në ministri, institucione qendrore, bashki dhe institucione të tjera publike që japin ndihmë shtetërore, për të garantuar njoftimin, raportimin dhe shkëmbimin e informacionit në kohë.

6. **Raportimi dhe llogaridhënia**: Autoriteti i Konkurrencës do të paraqesë raport vjetor në Kuvend mbi zbatimin e legjislacionit të ndihmës shtetërore, veprimtarinë monitoruese, vendimet e marra dhe ecurinë e rikuperimit të ndihmës së paligjshme.

7. **Kapacitetet administrative dhe profesionale**: Zbatimi i reformës do të mbështetet nga forcimi i burimeve njerëzore, financiare dhe teknike të Autoritetit të Konkurrencës, si dhe nga programe të vazhdueshme trajnimi për stafin përgjegjës në fushën e ndihmës shtetërore, monitorimit, analizës ekonomike dhe acquis të Bashkimit Evropian.

Aktet nënligjore: Për zbatimin e projektligjit do të kërkohet miratimi dhe/ose përditësimi i akteve nënligjore që rregullojnë procedurat e njoftimit, shqyrtimit dhe monitorimit të ndihmës shtetërore, mënyrën e administrimit dhe funksionimit të regjistrit të ndihmës shtetërore, procedurat e raportimit nga institucionet dhënëse të ndihmës, si dhe rregullat procedurale për mbledhjen e informacionit, monitorimin e zbatimit të vendimeve dhe ushtrimin e kompetencave të tjera të parashikuara në ligj. Aktet nënligjore do të miratohen brenda afateve të përcaktuara në dispozitat kalimtare të projektligjit.

1. .

Pengesat e mundshme dhe menaxhimi i risqeve

Gjatë implementimit, pritet të adresohen sfidat e mëposhtme:

- **Bashkëpunimi Institucionale:** Disa institucione dhënëse mund ta vlerësojnë pamundësi për njoftimin e detyrueshëm pranë Autoritetit të skemave të ndihmës. Kjo do të adresohet përmes proceseve "fast-track" për ndihmat me rrezik të ulët.

- **Kapacitetet e Bashkive:** Njësitë e vetëqeverisjes vendore shpesh kanë mungesë informacioni mbi rregullat e ndihmës shtetërore. Zgjidhja do të jetë krijimi i një platforme e-learning dhe manualeve të thjeshtuara.

- **Vonesat në Digjitalizim:** Zhvillimi i Regjistrit mund të hasë vonesa teknike. Si masë paraprake, do të përdoret një sistem raportimi gjysmë-manual i përkohshëm për të garantuar transparencën që në ditën e parë të ligjit.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

4. Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.

5. Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.

Monitorimi dhe vlerësimi i kësaj nisme janë komponentë tw rwndwsishwm për të siguruar që Shqipëria jo vetëm të transpozojë acquis të BE-së, por edhe ta zbatojë atë në mënyrë efektive në terren. Duke qenë se Kapitulli 8 (Konkurrenca) është një nga kapitujt më sfidues, krijimi i një mekanizmi llogaridhënës do të shërbejë si provë e "historikut të zbatimit" (track record) që kërkon Komisioni Evropian.

Në raportin e progresit të vitit 2025, BE-ja ka nënvizuar se Shqipëria duhet të garantojë pavarësinë operative të Autoritetit të Ndihmës Shtetërore dhe të rrisë transparencën e inventarit të skemave ekzistuese. Krijimi i sistemeve të monitorimit do të mundësojë kalimin nga një vlerësim formal ligjor në një vlerësim substancial të ndikimit të ndihmës në tregun e lirë.

Mekanizmi i Monitorimit

Strukturat përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin

Pas hyrjes në fuqi të ligjit, zbatimi dhe monitorimi i reformës do të realizohen nga Autoriteti i Konkurrencës dhe Komisioni i Konkurrencës, sipas kompetencave të përcaktuara në ligj. Gjatë periudhës kalimtare gjashtëmujore, Autoriteti i Konkurrencës dhe ministria përgjegjëse për ekonominë do të ndërmarrin masat organizative, administrative, financiare dhe teknike të nevojshme për transferimin e funksionit të kontrollit të ndihmës shtetërore.

Autoriteti i Konkurrencës do të jetë përgjegjës për ushtrimin e funksioneve administrative, teknike, hetimore dhe monitoruese në fushën e ndihmës shtetërore. Nëpërmjet strukturës përgjegjëse për ndihmën shtetërore, ai do të shqyrtojë njoftimet, do të mbledhë dhe verifikojë informacionin e nevojshëm, do të monitorojë zbatimin e vendimeve, do të administrojë

regjistrin e ndihmës shtetërore dhe do të ndjekë procedurat për pezullimin, ndryshimin ose rikuperimin e ndihmës së paligjshme ose të papajtueshme.

Komisioni i Konkurrencës do të ushtrojë kompetencat vendimmarrëse në fushën e ndihmës shtetërore, sipas parashikimeve të ligjit.

Aktet nënligjore: Për zbatimin e ligjit do të miratohen ose përditësohen aktet nënligjore të nevojshme që rregullojnë:

- procedurat e njoftimit, shqyrtimit dhe monitorimit të ndihmës shtetërore;
- mënyrën e administrimit dhe funksionimit të regjistrit të ndihmës shtetërore;
- procedurat e raportimit dhe shkëmbimit të informacionit nga institucionet dhënëse të ndihmës;
- procedurat për monitorimin e zbatimit të vendimeve dhe rikuperimin e ndihmës së paligjshme ose të papajtueshme;
- rregullat procedurale për mbledhjen e informacionit dhe ushtrimin e kompetencave të tjera të Autoritetit të Konkurrencës në fushën e ndihmës shtetërore.

Rezultatet e monitorimit do të pasqyrohen në raportin vjetor për zbatimin e rregullave të ndihmës shtetërore, të cilin Autoriteti i Konkurrencës e paraqet në Kuvend brenda datës 30 qershor të çdo viti për vitin pararendës.

Detyrat e Monitorimit:

Monitorimi do të kryhet përmes raporteve vjetore që Autoriteti do t'i paraqesë Kuvendit të Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, duke analizuar:

1. **Performancën e Njoftimeve:** Numrin e skemave të njoftuara nga ministritë/bashkitë kundrejt atyre të autorizuara.
2. **Efiçencën Administrative:** Kohëzgjatjen mesatare të vlerësimit të një kërkese (për të shmangur vonesat për biznesin).
3. **Integritetin e të Dhënave:** Funksionalitetin e plotë dhe përditësimin e Regjistrit online të Ndihmës Shtetërore.
4. **Ekzekutimin e Vendimeve:** Zbatimin e urdhrave të rikuperimit për çdo ndihmë të konstatuar si e paligjshme, duke siguruar që asnjë subjekt të mos përfitojë avantazh të padrejtë.

Vlerësimi i Rezultateve (KPIs)

Vlerësimi do të bazohet në Treguesit Kryesorë të Performancës (KPI), të cilët do të matin suksesin e reformës:

- **Përputhshmëria dhe Transpozimi:** Matet niveli i harmonizimit me Rregulloren (BE) 2015/1589 dhe Direktivën ECN+. Synimi është arritja e 100% të transpozimit deri në fund të vitit 2025.

- **Transparenca dhe Digjitalizimi:** Ky tregues do të matet përmes Regjistrit Digjital të Ndihmës. KPI-ja specifike do të jetë: *"Përqindja e skemave të ndihmës të publikuara online brenda 10 ditëve nga miratimi"*. Synimi është që 100% e ndihmës shtetërore (përfshirë atë *de minimis*) të jetë e gjurmueshme publikisht.
- **Efikasiteti i Rikuperimit:** Ky është treguesi më kritik për BE-në. Do të matet raporti midis ndihmës së konfirmuar si "e paligjshme/e papajtueshme" dhe shumës së rikuperuar realisht në arkën e shtetit brenda një viti kalendarik.
- **Ndikimi te NMV-të dhe Konkurrenca:** Përmes sondazheve vjetore, do të vlerësohet nëse ndërmarrjet e vogla dhe të mesme ndjejnë një mjedis më të drejtë konkurrues. Treguesi do të jetë: "*Ulja e perceptimit të bizneseve për favorizimin e ndërmarrjeve të mëdha përmes fondeve publike"*.
- **Kapacitetet Institucionale:** Numri i inspektimeve të kryera "ex-post" (pas dhënies së ndihmës) dhe numri i stafit të trajnuar për metodologjitë e reja të vlerësimit ekonomik (p.sh. vlerësimi i përfitimit në kushtet e tregut).

Marrja e Masave Korrigjuese

Nëse raportet e monitorimit evidentojnë devijime (si p.sh. institucione dhënëse që shpërndajnë ndihmë pa njoftim paraprak ose vonesa në raportim), Autoriteti i Konkurrencës, në bashkëpunim me dhënësit, ndërmerr masa korrigjuese të menjëhershme.

Këto masa përfshijnë:

- **Pezullimin e ndihmës:** Autoriteti i kërkon zyrtarisht dhënësve të ndihmës bllokimin e alokimit të fondeve për ato skema ose projekte që nuk kanë marrë miratimin paraprak (autorizimin) nga AK, deri në rregullimin e plotë të situatës ligjore.
- **Urdhër-kthimi i Ndihmës:** Për skemat që rezultojnë në kundërshtim me rregullat e konkurrencës, Autoriteti lëshon vendime të detyrueshme për rikuperimin e fondeve nga përfituesit, duke njoftuar organet e kontrollit financiar.
- **Optimizimin e Sistemeve IT:** Përmirësimin e moduleve në Regjistrin Digjital në bashkëpunim me AKSHI-n, për të thjeshtuar procesin e raportimit për Bashkitë dhe për të eliminuar pengesat teknike që çojnë në vonesa.
- **Rekomandime Strategjike:** Propozimin e ndryshimeve procedurale ose amendimeve të mëtejshme nëse vërehet se rregullat aktualë po bëhen pengesë për absorbimin e fondeve të BE-së (veçanërisht në kuadër të Planit të Rritjes – *Groëth Plan*), duke siguruar një ekuilibër mes kontrollit strikt dhe shpejtësisë së investimeve.

Ky proces monitorimi dhe korrigjimi garanton që reforma të shndërrohet në një instrument dinamik që mbron integritetin e taksapaguesve, siguron qëndrueshmërinë e fondeve publike dhe nxit një ekonomi tregu konkurruese sipas modelit evropian.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në 000/ lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Viti	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031	2032	2033
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 0	0	0	0
Opsioni 1			

Opsioni 2			

MINISTËR

DELINA IBRAHIMAJ